

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVE,—Departamenti për Krime te Rënda, Gjyqtari Shaqir Zika, Kryetari i Trupit Gjykues, me pjesëmarrjen procesmbajtëses Bute Ramosaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit Rr. A. H. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.2 nën par.2. 1 të KPRK-së, me aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Gjakove, —Departamenti për Krime te Renda PP/I.nr.262/2015, datë 09.01.2015, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më datën 03.02.2016, me pjesëmarrjen e Prokurorit te Shtetit te PTH në Gjakovë Ali Selimaj, i akuzuari Rr. H. si dhe mbrojtësi i tij Av. A. H. nga Gjakova, i caktuar sipas detyrës zyrtare, i dëmtuar S. K. nga Gjakova, të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: Rr. H., i lindur me ..., në Gjakove, nga i ati A. dhe ëma Z. e lindura M., i martuar, i ndarë, i ati i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datë te pa caktuar te muaj Gusht 2014, e gjere me dt. 20.08.2014, ne rrugën “Naum Veqilharxhi” ne Gjakovë, me qellim që vetit ti sjell përfitim pasurore te kundër ligjshëm i merr pasurinë te dëmtuarit S. K. nga Gjakova, ne atë mënyrë që duke e shfrytëzuar mos prezencën e të dëmtuarit ne shtëpi, me forcë e ka hapur derën e oborrit te shtëpisë, pastaj me forcë e ka hapur derën hyrëse të shtëpisë dhe nëpërmjet saj ka hyrë brenda dhe ne dhomën e fjetje te katit te dyte te shtëpisë, ka marr një qante ne te cilën kane qene një orë Zviceranë ne vlere prej 4.800€, dy pulla te vlefshme te këmishëve ne vlerë prej 100€, një mashë dekorative për kravatë ne vlerë prej 80€, katër unaza ne vlerë prej 4.000€, tri orë dore femrash ne vlerë prej 3.000€, një bylyzyk dore dhe një qafore ne vlerë prej 2.800€, dhe gjësende tjera ne vlere të përgjithshëm prej 15.000€, si dhe qelesat rezervë te automjetit ”BMW X 5”, dhe është larguar ne drejtim te pa njohur, me q rast te dëmtuarit i ka shkaktuar dem materiale ne vlere prej 15.000€.

- me çka ka kryer veprën penale te vjedhjes së rëndë nga neni 327 par. 2 nën par. 2.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 6, 17, 41, 43, 45, 62, para 2.2, 73, 74, 75, 76, par 1, nenit 327 par.2 nën par. 2.1 te KPRK-së, dhe neneve 359 par. 2, 366, 450 te KPPK-se, te akuzuarin.

E G J Y K O N

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vite, i cili dënim do te ekzekutohet ne afate prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit.

Obligohet i akuzuari që ti kthej te dëmtuarit S. K. gjërat e vjedhura: dhe atë një qante dore, një orë Zviceranë ne vlere prej 4.800€, dy pulla te vlefshme te këmishëve ne vlerë prej 100€, një mashë dekorative për kravatë ne vlerë prej 80€, katër unaza ne vlerë prej 4.000€, tri orë dore femrash ne vlerë prej 3.000€, një bylyzyk dore dhe një qafore ne vlerë prej 2.800€.

I akuzuari obligohet qe te paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa do te jene sipas llogarisë se kësaj Gjykate si dhe ne emër te paushallit gjyqësore shumen me nga 100€.te gjitha këto ne afate prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë,-Departamenti për Krime te Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.262/2014, dt. 09.01.2015, kundër- te akuzuarit Rr. A. H. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.2 nën par 2.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Ali Selimaj, i akuzuari Rr. H. se bashku me mbrojtësin e tij av. A. H., i caktuar sipas detyrës zyrtare, si dhe i dëmtuari S. K., dhe se ka pasur kushte për mbajtje te seancës se shqyrtimit fillestarë.

Pas leximit te aktakuzës ne seancën e shqyrtimit fillestarë, Gjykata është bindur se i akuzuari Rr. H., e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia qe te deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Me këtë rast Gjykata ka udhëzuar te akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit te fajësisë ne kuptim ne neni 326 te KPPK-se, kështu qe pas konsultimeve te nevojshëm me mbrojtësin e tij, i akuzuari ka deklaruar se është plotësisht i vetëdijshëm për rendësin e pranimit te fajësisë dhe ka shtuar se ky deklarim paraqet shprehje te vullnetit te tij te lire, pasi qe është kryes i kësaj vepre penale si në aktakuzë andaj ne tërësi ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, dhe se pranimi i fajësisë është i mbështetur ne provat te cilat i janë ofruar Gjykatës ne aktakuzë dhe ata kallëzimi penal i ushtruar nga Stacion Policor ne Gjakove, Njësia e Hetimeve, me nr.2014-DB-1452, te dt.11.11.2014, deklarata e të dëmtuarit S. K. te dhënë ne Prokurori me dt. 23.12.2014, raporti i oficerit B. A., i dt. 20.08.2014, deklarata e demit te dhënë nga i dëmtuari S. K. e dt. 26.12.2014, si dhe nga foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes.

Pas deklarimit te akuzuarit, për pranimin e fajësisë Kryetari i trupit gjykues kërkoj qe mendimin e vet ta jep Prokurori i Shtetit.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pajtohet me deklarinimin e te akuzuarit mbi pranimin e fajësisë dhe konsideron se një deklarinim i tille është plotësisht i vullnetshme nga ana e te akuzuarit dhe i njëjti mbështetet ne prova qe janë ne shkresat e lendes, dhe atë në kallximin penale te parashtruar nga Stacion Policore ne Gjakovë, mbrojtja e të akuzuarit, deklarata e të dëmtuarit S. K., si dhe nga foto dokumentacioni i vendit te ngjarjes, si dhe i akuzuari te dëmtuarit ja ka kthyer qelesat e veturës, andaj i ka propozuar Kryetarit të Trupit Gjykes qe ta aprovoj pranimin e fajësisë së të akuzuarit, pasi qe i njëjti është konsultuar me mbrojtësin e tij avokatin A. H..

I dëmtuari S. K., ka deklaruar; se ka dhënë deklarate ne Prokurori ne lidhje me rastin dhe ne tërësi ngel pranë asaj deklarate, dhe ka kërkuar nga i akuzuari qe te kompensohet për dëmin apo ti ktheje sendet e vjedhura, ndërsa sa i përket ndjekjes penale Gjykatës ja ka lenë ne vlerësim, pasi qe me te njëjtin është ne raporte familjare, është djali i vëllaut te gruas.

Mbrojtësi i te akuzuarit Rr. H., av. A. H., ka deklaruar se: pas konsultimeve te nevojshëm me te mbrojturin tim, duke i shpjeguar favoret dhe pasojat e pranimit te fajësisë dhe i njëjti ne mënyrë vullnetare ka pranuar fajësinë për vepër penale qe i vihet ne barrë sipas aktakuzës, andaj i propozoi Kryetarit te Trupit Gjykes qe te aprovoi pranimin e fajësisë së te akuzuarit dhe me rastin e caktimit te llojit dhe lartësisë së dënimit Gjykatë te merr parasysh rrethana posaçërisht lehtësuese i akuzuari ka pranuar fajësinë për vepër penale është i moshës së re, i ati i tre fëmijëve, me parë nuk ka qene i dënuar, ka shprehur pendimin e thellë, i ka kërkuar falje te dëmtuarit dhe veprën e ka kryer nen ndikim te alkoolit, andaj me një dënim nën minimumin e parapare Ligjore do te arrihet qëllimi i dënimit i parapare me Ligj.

I akuzuari Rr. H., ne tërësi është pajtuar me deklarinimin e mbrojtësit te tij, dhe i ka kërkuar falje te dëmtuarit ne këtë seancë te shqyrtimit fillestar.

Ne vijim, Gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje te vullnetit te lire te akuzuarit, pasi qe të njëjti i janë shpjeguar favoret dhe pasojat, dhe ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, dhe pranimi i fajit është bere ne pajtim me dispozitat ligjore dhe ky pranim mbështetet ne provat qe janë ne aktakuze konform nenit 326 te KPK-se.

Duke pasur parasysh që Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethane nga neni 248 te KPPK-se si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 326 te KPPK-se, e këtë qeshje penale nuk është zbatuar procedura e provave por gjykata shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar ne fjalën përfundimtare te palëve ne kuptim te nenit 352 te KPPK-se.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajit nga e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, andaj ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha tiparet e veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 para 2 nën par. 2.1.te KPRK-së, për të cilën vepër i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe është ndëshkuar si ne dispozitave te këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit Gjykata i ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit dhe Gjykata ka zbutur dënimin nën kufirin e parapare me Ligj, duke marrë parasysh rrethanat posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë së të akuzuarit, veprën e penale e ka kryer nën ndikim të alkoolit, ka shprehur pendimin e thelle, sjelljen e tij te mirë pas kryerjes se veprës penale, është i moshës së re, i ati i tre fëmijëve, me herët nuk ka qene i gjykuar, andaj Gjykata te njëjtit ja ka shqiptuar dënimin me burgim në 1 (një) vite, nën minimumin e paraparë ligjor me shpresë dhe bindje se edhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me ligj, Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar ndaj te akuzuarit është ne harmoni me shkallës e përgjegjësisë penale te akuzuarit dhe peshës se veprave penale, kështu qe dënimi i shqiptuar me burg, do ta arrij qëllimin e dënimit te parapare me dispozitat e nenit 41 te KPK-se.

Vendimi mbi obligimin e të akuzuarit që të kompensoi dëmin e shkaktuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbështetet në dispozitat e nenit 463 par.1 lidhur me nenin

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor 100 (një qindë)€, bazohet ne dispozitat e nenit 450 par 3 të KPPK-se.

Nga arsye at e cekura me larte dhe me zbatimin e neni 365 par. 1 te KPPK-se është vendosur ne dispozitave te këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË,-Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.6/15, me dt. 03.02.2016,**

**Procesmbajtësja
Bute Ramosaj**

**Kryetari i trupit gjykues
Shaqir Zika**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankese ne afate prej 15 dite, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.